

Refuzimi i dhënies së fondeve publike një partie politike e cila nuk ka plotësuar kriterin e përfaqësimit, nuk e shkel të drejtën për shprehjen e lirë të mendimit të popullit

Në vendimin e sotëm të Dhomës në çështjen [OzqurlukVeDavanismaPartisi \(ODP\) kundër Turqisë](#) (ankimi nr. 7819/03), i cili nuk ka marrë formë të prerë¹, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut vendosi unanimisht se:

Nuk ka shkelje të Nenit 14 (ndalim i diskriminimit) në lidhje me Nenin 3 të Protokollit Nr. 1 (e drejta për zgjedhje të lira) e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Çështja kishte të bënte me refuzimin për ti dhënë financim të drejtpërdrejtë publik, të parashikuar nga Kushtetuta turke, një partie politike, ODP, e cila nuk plotësonte kriterin minimal të përfaqësimit.

Gjykata konstatoi në mënyrë të veçantë se dallimi në trajtim midis ODP dhe partive të cilat merrnin financime ishte në mënyrë të arsyeshme në proporcion me qëllimin legjitim të forcimit të pluralizmit demokratik duke shmangur fragmentarizimin e listave të kandidatëve.

Faktet kryesore

Partia ankuese, OzgurlukVeDayanişma Partisi ("ODP", Partia për Lirinë dhe Solidaritetin), është një parti politike turke me bazë në Ankara. Në nëntor 1998, Ministria e Financave hodhi poshtë kërkesën e partisë ankuese për ndihmë financiare e parashikuar në Kushtetutën turke për partitë politike, me arsyetimin se ajo nuk i plotësonte kriteret e përshtatshmërisë. ODP kishte marrë më pak se 7% të votave të hedhura në zgjedhjet e mëparshme parlamentare, kufiri minimal i dhënies së të drejtës për financim të drejtpërdrejtë nga shteti.

Partia ankuese e kundërshtoi këtë vendim, duke argumentuar në mënyrë të veçantë se kriteret e vendosura në ligj i pengonin partitë të cilat nuk ishin të përfaqësuar në Parlament, të përfitonin fonde shtetërore. Ajo tërhoqi vëmendjen për vështirësinë e fushatave pa burimet e nevojshme financiare dhe pohoi se refuzimi ishte jokushtetues dhe në kundërshtim me detyrën e shtetit për të promovuar të drejtat, liritë demokratike si dhe parimin e mosdiskriminimit. Ankesa u hodh poshtë nga Gjykata e Lartë Administrative në një vendim të marrë më 25 prill 2002.

¹ Sipas Neneve 43 dhe 44 të Konventës, ky gjykim i Dhomës nuk është i formës së prerë. Gjatë periudhës tre mujore pas dhënies së tij, çdo palë mund të kërkojë që çështja t'i kalojë Dhomës së Madhe të Gjykatës. Nëse bëhet një kërkesë e tillë, një trup prej pesë gjyqtarësh shqyrton nëse çështja meriton shqyrtim të mëtejshëm. Në këtë rast, Dhoma e Madhe do të dëgjojë rastin dhe do të japë një gjykim përfundimtar. Nëse kërkesa për referim refuzohet, gjykimi i Dhomës do të jepet në formë të prerë në atë ditë.

Pasi një aktgjykim bëhet i formës së prerë, ai i transmetohet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të tij. Informacione të mëtejshme në lidhje me procesin e ekzekutimit mund të gjeni këtu: www.coe.int/t/dghl/monitoring/execution

Ankimimet, procedura dhe përbërja e Gjykatës

Partia ankuese pretendonte se, refuzimi asaj i dhënies së fondeve të dhëna për partitë e tjera, me arsyetimin se ajo kishte marrë më pak se 7% të votave të hedhura në zgjedhjet e mëparshme parlamentare, shteti e kishte diskriminuar atë, duke e vendosur atë në një disavantazh në fushatat elektorale të viteve 1999, 2002 dhe 2007. Në këtë mënyrë, shteti kishte shkelur shprehjen e lirë të mendimit të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës. Ajo u mbështet në nenet 9 (e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë), 10 (liria e shprehjes), 11 (liria e tubimit dhe e organizimit) dhe 14 (ndalimi i diskriminimit).

Kërkesa u parashtrua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në 1 tetor 2002.

Gjykimi u dha nga një Dhomë prej shtatë anëtarësh, e përbërë si vijon:

Françoise **Tulkens** (Belgjikë), *Kryetar*,

Danute **Jociene** (Lituani),

Dragoljub **Popovic** (Serbi),

Andras **Sajo** (Hungari),

Işil **Karakaş** (Turqi),

Guido **Raimondi** (Itali),

Paulo Pinto de Albuquerque (Portugal), *gjyqtarë*, dhe gjithashtu Stanley Naismith, *Regjistruer i Seksionit*.

Vendimi i Gjykatës

Neni 14 në lidhje me Nenin 3 të Protokollit Nr. 1

Së pari, Gjykata shqyrtoi ankesën e ankuesit sipas Nenit 14 në lidhje me Nenin 3 të Protokollit nr. 1. Gjykata vuri në dukje se partia ankuese ishte trajtuar ndryshe në ushtrimin e të drejtave të saj zgjedhore sipas Nenit 3 të Protokollit nr.1 për shkak të përdorimit të sistemit në fjalë. Ishte e qartë se ODP, pasi nuk ka marrë fonde, ishte në disavantazh nga sistemi për financimin publik të partive politike në krahasim me rivalët e saj, të cilat kishin marrë ndihmë dhe ishin në gjendje për të financuar shumë më lehtë përhapjen e mendimeve të tyre në nivel kombëtar. Gjykata duhet të konstatonte nëse sistemi në fjalë ndiqte një qëllim legjitim dhe nëse kishte pasur një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur.

Financimi publik i partive politike kishte për qëllim forcimin e pluralizmit politik dhe kontribuimin në funksionimin e duhur të institucioneve demokratike, me qëllim shmangien e korrupsionit dhe mbështetjen tek donatorët privatë. Në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës - të cilat kishin rregulla të ndryshme në këtë fushë - ato që kishin një sistem për financim të barabartë, me fjalë të tjera, një të tillë që varej nga rezultatet e partive në zgjedhjet e mëparshme, kërkohej gjithnjë një shkallë minimale përfaqësimi - ndërmjet 0.5% dhe 5% të votive të hedhura.

Ky nivel minimal, pa të cilin ndoshta do të kishte një rritje të shpejtë në numrin e kandidaturave, duke pasur parasysh që çdo votë e marrë siguronte të ardhurat vjetore si fondet publike, nuk ishte gjetur i paarsyeshëm nga Këshilli i Evropës dhe institucionet e specializuara¹, me kusht që ai të mos ishte tepër i lartë dhe që partitë kryesore politike të mos monopolizonin fondet publike.

Kështu, financimi publik i partive politike ka ndjekur qëllimin legjitim të forcimit të pluralizmit demokratik, duke shmangur fragmentarizimin e tepruar dhe jofunksional të

¹ " Udhëzime për Rregulloren e Partive Politike ", nga OSCE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias, dhe miratuar nga ky I fundit në seksionin e tij të 84 (Venecia, 15-16 tetor 2010, [GDL-AD\(2010\)024](#)). Shih §20 të gjykimit.

